- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

---

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 1/1.**

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet]*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*], përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne [*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*].

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur nëvlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
------------------------------------	--

<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )*

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**

\_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallratduhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimevepër artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njesi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					

	<b>Çmimi total (Mallrat)</b> _____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>	
<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 3.**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]  
 [Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrimishkurtërikontratës: [objekti]

Publikimi(nësezbatohet):BuletiniiiNjoftimevePublike [Data] [Numri]/Nr.Referencësnëfaqen e APP-së

\* \* \*

Duke iureferuarprocedurëssëlartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emriiofertuesittësiguruar] ka derdhurnjëdepozitëpranë[emridheadresa e bankës] / ështëgarantuarpranë[emridheadresa e kompanisësësigurimit] me njëvlerëprej[monedhadhevlera, e shprehurnëfjalëdheshifra] sikushtpërsigurimin e ofertës, dorëzuarngaoperatoriilartpërmendurekonomik.



Marrimpërsipërtëtransferojmënëllogarinë e [emriiautoritetitkontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ngakërkesajuaj e thjeshtëdhe e parë me shkrim, pa kërkuarshpjegime, me kushtqëkjokërkesëtëpërmendëmospërmëshjen e njëritngakushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequrose ka ndryshuarofertën, pas afatitpërfundimtarpërparaqitjen e ofertaveose para afatitpërfundimtar, nëseështëpërcaktuarkështunëdokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4.

(Shtojcëpër tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

### **Nënshkrimi**

### **Vula**

## **Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj: bashkëngjitur

---

Specifikimi i Materialeve: : bashkëngjitur

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: : bashkëngjitur

### Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

#### “Blerje ushqime per QDM”

Nr.	LLOJI I MALLIT	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Vezë	kokrra	24,420		
2	Mish viçi	kg.	1,600		
3	Sallam	kg.	1,188		
4	Mish pule(pula vendi)	kg.	2,000		
5	Qumësht me kuti 1 lt.	litra	2,400		
6	Kos me shishe 1 lt	litra	2,000		
7	Gjalp	kg.	440		
8	Bukë 1 kg.	kg.	5,500		
9	Sheqer	kg.	176		
10	Makarona	kg.	1,320		

11	<b>Oriz</b>	kg.	1,100		
12	<b>Fasule</b>	kg.	450		
13	<b>Vaj ulliri</b>	litra	100		
14	<b>Vaj vegjetal</b>	litra	880		
15	<b>Miell gruri</b>	kg.	264		
16	<b>Kripë</b>	kg.	440		
17	<b>Salcë</b>	kg.	352		
18	<b>Niseshte</b>	kg.	55		
19	<b>Kafe turke p.100gr</b>	cope	352		
20	<b>Caj me kokrra</b>	kuti	352		
21	<b>Lëng limoni</b>	shishe	80		
22	<b>Ujë i pijshëm 5 - 6 lt.</b>	copë	100		
23	<b>Patellxhan</b>	kg.	40		
24	<b>Patate</b>	kg.	1,800		
25	<b>Karrota</b>	kg.	220		
26	<b>Qepë e thatë</b>	kg.	880		
27	<b>Domate</b>	kg.	50		
28	<b>Speca</b>	kg.	50		
29	<b>Presh</b>	kg.	100		
30	<b>Kungull</b>	kg.	50		
31	<b>Lakër</b>	kg.	100		
32	<b>Bizele</b>	kg.	450		
33	<b>Majdanoz</b>	tufa	38		
34	<b>Mollë</b>	kg.	360		
35	<b>Portokalle</b>	kg.	360		
36	<b>Banane</b>	kg.	400		

---

**Afatet e lëvrimet:12 muaj**

**Afati i skadencës të jetë jo mëpak se 1 vitë, sipas specifikimeve teknike**

<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Destinacioni</b>	<b>Periudha e dorëzimit</b>

#### **Shtojca 7**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

---

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

---

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

- b. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..
- c. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1'000'000 lekë

2. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që

kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate ISO 9001-2015 *”Per menaxhimin e cilesise”* objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, ISO 22000: 2018 *sistemin e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore”* objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** Paisja me këto certifikata ISO, garanton që OE konkuroes plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm si dhe plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, jo më pak se 4 punonjës si më poshtë:

- a. 2 Drejtues mjete
- b. 2 Punetorë të thjeshtë

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Per punonjesit e punesuar si drejtues mjete leje drejtimi tipit B per secilin.
- Per punonjesit e punesuar punetore te thjeshte të paraqitet vetem kontrate pune përkatëse.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 4 drejtues mjete, OE paraqet jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.



---

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetete si mëposhtme:

- Një mjet transporti ATV frigoriferik
- Një mjet transporti ATP jo frigoriferik

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet në pronësi ose në përdorim përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Arsyeja përse është kërkuar automjeti ATV është bërë duke marrë parasysh kushtet në të cilat duhet të kryhet transporti i i produkteve. Duke iu referuar Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, për transportin e këtyre produkteve kërkohen kushte frigoriferike, për rrjedhojë, njëri nga automjetet kërkohet të jentë frigoriferikë, d.m.th ATV.

2.3.6 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence sipas objektit të prokurimit:

*Licence lëshuar nga Qendra Kobëtare e Biznesit (QKB)*

*Kategoria II ”Prodhim dhe/ose tregtimi i ushqimeve.*

*Nënkategoria II.1.A.1 ”Prodhimi, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”*

**(sqarim: licenca duhet të jetë në emër të OE të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shapallur nga AK).**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, Informacionit mbi Liçensat, si dhe referuar Rekomandimit të Agjensisë së prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar i Ushqimeve nr. 10181 prot. Date 19.11.2018.

2.3.7 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi të mishit të vicit në pronësi ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

*Certifikatë rregjistrimi marrë nga Qendra Kobëtare e Biznesit (QKB)*

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Leje higjeno-santare*

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar ligjit për tregtarët dhe njesitë e tregtimit si dhe rekomandimit të Agjensisë së prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimeve nr. 10181 prot. Date 19.11.2018,. Siç është parashikuar në specifikimet teknike mishit të viçit. Ky produkt (mish) do të konsumohet prej të moshuarve dhe është detyrë e Qendres Ditore të Moshuarve përcaktimi i kushteve dhe standarteve të lëvrimit të këtij produkti në mënyrë rigoroze.*

**2.3.8** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi të mishit të pulës në pronësi ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

*Certifikatë rregjistrimi marrë nga Qendra Kobëtare e Biznesit (QKB)*

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Leje higjeno-santare*

**Argumentimi:** *Vendosja e këtyre kritereve konsiston në faktin që, Qendra Ekonomike e Arsimit furnizon çdo ditë me mish të freskët pulë kopshte dhe çerdhe të qytetit.*

*Autoriteti kontraktor e bën porosinë për mish pulë tek furnitori, çdo ditë, pasi ka llogaritur nevojat ditore.*

*Për përmbushjen e këtyre kërkesave, kontraktori duhet të vërtetojë se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për t'iu përgjigjur kërkesave të Autoritetit Kontraktor, çdo ditë për sasinë dhe parametrat e kërkuar.*

*Për nga natyra e produktit, furnizimi me mish është jetësor dhe shumë delikat. Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimeve ditore, sasinë e kërkuar dhe për të garantuar që produkti të jetë brenda të gjitha parametrave të kërkuar, ekzistenca e kompleksit është garanci. Kjo garanton faktin se operatori ekonomik i ka mundësitë dhe kapacitetet furnizuese, duke vërtetuar kapacitetet e mbarështrimit dhe majmërimit të pulave.*

**2.3.9** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi të vezëve të pulës në pronësi ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

*Certifikatë rregjistrimi marrë nga Qendra Kobëtare e Biznesit (QKB)*

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Leje higjeno-santare*

**Argumentimi:** *Sasia totale e nevojave të parashikuar për vezë pulë është e konsiderueshme, Autoriteti kontraktor e bën porosinë për vezë pulë tek furnitori, çdo ditë, pasi ka llogaritur nevojat ditore. Për përmbushjen e këtyre kërkesave, kontraktori duhet të vërtetojë se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për t'iu përgjigjur kërkesave të Autoritetit Kontraktor, çdo ditë për sasinë dhe parametrat e kërkuar. Për nga natyra e produktit, furnizimi me vezë pulë është parësore dhe shumë delikate. Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimeve ditore, sasinë e*

---

*kërkuar dhe për të garantuar që produkti të jetë brenda të gjitha parametrave të kërkuar, ekzistenca e nje marrveshje apo kontrate apo akt pronësie është garanci. Kjo garanton faktin se operatori ekonomik i ka mundësitë dhe kapacitetet furnizuese.*

**2.3.10** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi të qumështit, djathit, kosit nenproduktet e tij etj., në pronësi ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

*Certifikatë rregjistrimi marrë nga Qendra Kobëtare e Biznesit (QKB)*

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Leje higjeno-santare*

***Argumentimi:** Sasia totale e nevojave të parashikuar për qumështin dhe nen produktet e qumështit është e konisderueshme, Autoriteti kontraktor e bën porosinë tek furnitori, çdo ditë, pasi ka llogaritur nevojat ditore. Për përmbushjen e këtyre kërkesave, kontraktori duhet të vërtetojë se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për t'iu përgjigjur kërkesave të Autoritetit Kontraktor, çdo ditë për sasinë dhe parametrat e kërkuar. Për nga natyra e produktit, furnizimi me produktet dhe nenproduktet e qumështit është parësore dhe shumë delikate. Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimeve ditore, sasinë e kërkuar dhe për të garantuar që produkti të jetë brenda të gjitha parametrave të kërkuar, ekzistenca e nje marrveshje apo kontrate apo akt pronësie është garanci. Kjo garanton faktin se operatori ekonomik i ka mundësitë dhe kapacitetet furnizuese.*

**2.3.11** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi të ushqimeve të ambalazhuara (koloniale) në pronësi ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

*Certifikatë rregjistrimi marrë nga Qendra Kobëtare e Biznesit (QKB)*

- *Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit.*
- *Leje higjeno-santare*

***Argumentimi:** Vendorsja e ketyre kriterëve konsiston ne faktij qe, Qendra Ditore e të Moshuarve furnizohet cdo ditë me ushqime koloniale si mjell, vaj, sheqer, makarona etj, pasi ka llogaritur nevojat ditore QDM. Kërkesa për Leje higjeno-sanitare është kërkuar për përcatimin e këtij kriteri komisioni i është referuar sasise së konsiderueshme të ushqimeve të planifikuar për tu furnizuar çdo ditë për furnizimin e çerdheve dhe kopshteve të Bashkisë së Durrësit.*

**2.3.12** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi të fruta, zarzavate në pronësi ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

*Certifikatë rregjistrimi marrë nga Qendra Kobëtare e Biznesit (QKB)*

- Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit Ose .
- Kartë fermeri
- Leje higjeno-santare

**Argumentimi:** Në specifikimet teknike të produkteve është përcaktuar që ato kërkohen të jenë të freskëta. Ato nuk duhet të jenë të ruajtura në frigoriferë pasi qendra furnizohen me këto produkte 1 ditë para se ato të konsumohen. Kështu që frutat dhe zarzavatet duhet të jenë prodhime të freskëta dhe jo të magazinuara.

Kapacitetet e kërkuara të serrave, janë në përputhje me sasinë e konsiderueshme të nevojave për këto produkte të parashikuara në zbatim të kontratës.

**2.3.13** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë njësi tregtimi të bukës së grurit, integral dhe theker, në pronësi ose kontratë bashkpunimi/ ose furnizimi me njësinë e prodhimit dhe /ose tregtimt:

*Certifikatë rregjistrimi marrë nga Qendra Kobëtare e Biznesit (QKB)*

- Ekstrakt tregtar, ku fusha e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti i prokurimit
- Leje higjeno-santare

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB, Leje Higjeno-Santare Për përcatimin e këtij kriteri komisioni i është referuar sasise së konsiderueshme të bukës të planifikuar për tu furnizuar çdo ditë. Plotësimi i këtij kriteri do të garantonte zbatimin me korrektesë të kontratës.

**SQARIM:** Për Operatorin Ekonomik të cilët kanë marrveshje furnizimi ose kontratë bashkpunimi, me njësitë e tregtimit sipas kërkesave të kërkuara nga AK, OE duhet të dokumentojë kontratat e bashkëpunimit me secilin prej tyre dhe dokumentacioni i kërkuar për të marrë pjesë si më sipër duhet të jenë në emër të personit përgjegjës të lidhjes së kontratës/marrveshjes së bashkëpunimit. (Periudha e bashkëpunimit/furnizimit të përfshijë afatet e parashikuar në zbatimin kontratës me AK.)

*(Sqarim: Kjo kërkesë i referohet rekomandimeve të Agjensisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëar të Ushqimeve Nr. 10181 prot. Date 19.11.2018)*

## **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Për hartimin e specifikimeve teknike është patur parasysh, natyra e përdorimit të produkteve ushqimore si produkte ushqimor në përbërje të menisë së miratuar me Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, dhe Urdhërit nr. 457, datë 13.06.2018, Për një ndryshim të Urdhrit

---

nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, Hartimi i specifikimeve teknike, nga ana e Komisionit, është kryer duke iu referuar:

- Standardeve Shtetërore në fuqi STASH, për çdo artikull.
- Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar,
- VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”,
- Udhëzimin nr. 5, datë 25.03.2011 “Për kërkesat specifike të higjenës për stabilimentet e prodhimit, grumbulimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumshti”,
- Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.
- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”,
- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
- Udhëzimin nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645 datë 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014 Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
- Udhëzimin nr. 15, datë 09.09.2021 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “për Kriteret Mikrobiologjike për produktet ushqimore.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Deklarata Shtojca 8.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I:**

**Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik**

**(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul>
---

Emri i nënkontra-ktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

\_\_\_\_\_

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_



Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të

- operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). □
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## **C: DEKLARATA**

### **Mbi Konfliktin e Interesit**

## D: DEKLARATA

### Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [ ] Jo [ ]

## Pjesa IIIV: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

### A: DEKLARATË

#### Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

